# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-462654**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Balluku ka folur me Ron Yeffet për tregti armësh nga Afrika”/ Gazetari: SPAK pritet të hetojë vilën e tretë të saj \| |
| ADRESA | `https://boldnews.al/2026/09/23/balluku-ka-folur-me-ron-yeffet-per-tregti-armesh-nga-afrika-gazetari-spak-pritet-te-hetoje-vilen-e-trete-te-saj/` |
| BURIMI | boldnews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 18:50:38 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 13:40:14 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `ba37c9e8dd623d9d54627e9cde71fcf8195f6afa5cd45fcb492de1532afba9fb` |
| TEKSTI | `d3aacf55b1581c4f7e3a05db01f3da2d0988d0bfb73c19efd9e7dfb8b88ab07e` |
| PAMJA | `d979a22bb1810b90704e8bdfc8654994c2205826d710c3200388356c6cc9cfcb` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `d38d6056718fae466d1f279a0955d0dd0e58944e5e26730d8e4d1b4708f01f3a` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/d38d6056718fae466d1f279a0955d0dd0e58944e5e26730d8e4d1b4708f01f3a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# "Balluku ka folur me Ron Yeffet për tregti armësh nga Afrika"/ Gazetari: SPAK pritet të hetojë vilën e tretë të saj

15:40 : 23/09/2026 në AKTUALITET, POLITIKE



Në vijim të denoncimeve të tij lidhur me hetimet e Prokurorisë së Posaçme (SPAK) ndaj funksionarëve më të lartë të ekzekutivit, gazetari Almer Toska ka dhënë detaje të reja mbi dosjen që lidhet me tregtinë ndërkombëtare të armëve dhe hetimin pasuror ndaj zëvendëskryeministres Belinda Balluku.

Toska nënvizoi se ish-zëvendëskryeministri Arben Ahmetaj zotëron materiale të përgjuara nga një shtet partner i NATO-s, të cilat i janë kaluar drejtësisë gjermane dhe tashmë ndodhen në duart e SPAK-ut.

*"Arben Ahmetaj është personi që ka 3 orë përgjime të Ron Yeffet, i cili është përgjuar nga një shtet anëtar i NATO-s. Më pas i ka kaluar Gjermanisë dhe ato përgjime që ka Arben Ahmetaj, sot i zotëron edhe SPAK-u. Një nga njerëzit që ka komunikim me Ron Yeffet është edhe Belinda Balluku. SPAK e ka këtë komunikim dhe flitet e diskutohet për tregtinë e armëve nga Afrika."*

Sipas gazetarit, kjo dosje tejkalon çdo aferë korruptive financiare ose ndërtimore, ndërsa pretendoi se ngadalësimi i procedurave nga SPAK bëhet për të konsoliduar provat përpara kërkesës zyrtare për heqjen e imunitetit në Kuvend.

*"Kjo është akuza edhe më e rëndë për Ballukun se aferat e rrugëve. Kur kjo është e faktuar, SPAK nuk ka çfarë pret më për të kërkuar imunitetin e Ballukut në Parlament.*

**Lexo edhe:**

Tomorri: Balluku ka marrë peng Aeroportin e Vlorës, Shqipëria mund të humbasë gjyqin 700 mln euro

Ahmetaj për Ballukun: Plaçkitësja është një kalë i ndodhur i florinjtë me barkun me diamante

*Por ecuria e provimit të gjërave po i jep SPAK-ut një ngadalësim, në mënyrë që Rama të mos jetë kundërshtues i kërkesës së arrestimit të shoqëruar me prova. Një vend i NATO-s që përfshihet me një mashtrues ndërkombëtar si Ron Yeffet, çfarë garancie ka NATO nga ky vend, kur kryeministri e përdor trafikun e armëve për të qëndruar në pushtet?"*

TË GJITHA


9 faqet e SHISH në makinën e Agasit, bashkëpunim apo nxjerrje informacioni? Ku nis përgjegjësia penale?
20:42 : 23/09/2026


Arrestohet në Rusi Shpëtim Aliu, një nga "bossët" e rrjetit të trafikut ndërkombëtar të kokainës
20:32 : 23/09/2026


Administrata Trump po përgatit planin për ndalimin 90-ditor të eksporteve të naftës
20:17 : 23/09/2026


Stresi dhe inflamacioni mund të dëmtojnë zemrën në heshtje
20:17 : 23/09/2026


Berisha përjashton bojkotin e Parlamentit: Do ishte në favor të Ramës
20:04 : 23/09/2026


Dosja e SHISH, Salianji: Shteti ka rënë në duart e bandave
19:55 : 23/09/2026


Haxhiu i ftoi në takim, familjarët e 4 ish-krerëve të UÇK-së refuzojnë: Pasi Kuvendi të marrë vendim për Hagën
19:47 : 23/09/2026

Përveç këtyre, Toska paralajmëroi edhe zhvillime të reja në rrafshin e hetimit pasuror ndaj numrit dy të qeverisë.

*“Ballukut shpejt SPAK do i nxjerrë edhe një vilë të tretë, do e faktojë që është e Belinda Ballukut,”* përfundoi gazetari Almer Toska.

**Etiketa:** almer toska belinda balluku

**Lajme të lidhura**



**Tomorri: Balluku ka marrë peng Aeroportin e Vlorës, Shqipëria mund të humbasë gjyqin 700 mln euro**

22:49 : 21/09/2026



**Ahmetaj për Ballukun: Plaçkitësja është një kalë i ndodhur i florinjtë me barkun me diamante**

21:41 : 21/09/2026




**Nën hetim për dosjen “Balluku”/ Igli Tare del nga SPAK pas 5 orësh, kyç gojën para gazetarëve**

15:18 : 21/09/2026



**Fshehu vilat e Ballukut/ Igli Tare paraqitet në SPAK**

09:58 : 21/09/2026



**“SPAK mos të presë Ramën”/ Bardhi: Ku është kërkesa për arrestimin e Ballukut?**

19:00 : 19/09/2026



**“Klienti specifik”/ Lala: Si fshihej emri i Ballukut në dosjen e vilës luksoze në Palasë**

17:26 : 19/09/2026

BOLD NEWS

**RRETH NESH**

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.
Na kontakto: [email protected]

**NA NDIQ**

2026 Boldnews Dev By Techzero1.com

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.